



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe veterinarisë

Departamenti: Pemëtari - Vreshtari

Programi: Pemëtari Vreshtari

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Hamite Matmuja Salihu, me titull: **“Hulumtimi i mbirjes së kokrrave të polenit te kultivari i mollës Starking”**

ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 12 deri me datë 19.12.2023.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. dr. Bedri Dragusha kryetar
2. Prof. asoc. Vahid Avdiu mentor - anëtar,
3. Prof. ass. Gëzim Hodolli anëtarë, anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. asoc. Vahid Avdiu , përmes e-mail adresës vahid.avdiu@uni-pr.edu.

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji është mund të jetë një pasurim i punës tonë !

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

DEPARTAMENTI PEMËTARI -VRESHTARI

PROGRAMI PEMËTARI -VRESHTARI



Tema:

**“HULUMTIMI I MBIRJES SË KOKRRAVE TË POLENIT TE KULTIVARI I
MOLLËS STARKING ”**

Mentor:

Prof. Ass. Dr. Vahid Avdiu

Kandidati:

Bsc. Hamite Matmuja Salihu

Prishtinë, 2023

ABSTRAKTI

Studimi është kryer në vitin 2023 në fermën didaktike të FBV-së dhe në laboratorin e Pemëtarisë. Në këtë studim është prezantuar hulumtimi i mbirjes së kokrrave të polenit tek kultivari i mollës Starking. Njëkohësisht në këtë hulumtim është përfshirë edhe formimi dhe zhvillimi i frutave në bimët ku janë marrë lulet për hulumtim si dhe ndikimi i faktorëve klimatik në këtë proces. Pjalmimi dhe pllenimi janë bazat kryesore mbi të cilat zhvillohet frutifikimi i suksesshëm i mollës. Mbirja e kokrrave të polenit është një prej proceseve më të rëndësishëm gjatë pllenimit që rezulton me formimin e farës dhe zhvillimin e frytit. Si një proces i ndërlikuar mbirja e kokrrave të polenit ndikohet nga shumë faktorë të jashtëm dhe të brendshëm. Ky studim ka për qëllim të vë në pah ndikimin e disa prej këtyre faktorëve në mbirjen e polenit te kultivari i mollës Starking, në kushtet agrometeorologjike të Prishtinës. Gjatë procesit të hulumtimit është përdorur metoda e “pikës së varur” përkatësisht përdorimi i tretësirës së saharozës si teren ushqyese për mbirjen e kokrrave të polenit. Lulet janë marrë në tri fenofaza të lulëzimit: fillimi i lulëzimit, lulëzimi i plotë dhe përfundimi i lulëzimit, pastaj kokrrat e polenit të veçuara nga anterat janë vendosur në tretësirat e saharozës me përqendrim 10%, 15% dhe 20%. Procesi i mbirjes është vëzhguar në përmes mikroskopit elektronik për 120 minuta (10’ 20’ 30’ 40’ 50’ 60’ dhe 120’), dinamika e mbirjes së polenit është regjistruar përmes fotografive të realizuara përmes kamerës së mikroskopit. Gjatë hulumtimit të mbirjes së kokrrave të polenit është vërejtur se një pjesë e kokrrave të polenit nuk arrijnë të mbijnë, një pjesë arrijnë vetëm të fillojnë mbirjen pastaj gypi gjerminativ nuk zgjatet, një pjesë tjetër para ose pasi të fillojnë të mbijnë dhe gjatë zhvillimit të gypi gjerminativ shpërthen (aborton) dhe një pjesë tjetër arrin të zhvilloj normalisht gypin gjerminativ. Në përgjithësi kokrrat e polenit më së tepërmi janë aktivizuar në përqendrimin e saharozës 20 % dhe 15 %. Gjatë 120 minutave të mbikëqyrjes së mbirjes së kokrrave të polenit, në intervalin kohorë 10 – 20 minuta ka ndodhë pjesa dërmuese e incimit të mbirjes dhe mbirjes së plotë të kokrrave të polenit ndërsa abortimi ka ndodhë më së tepërmi në intervalin kohorë 60 – 120 minuta. Nga kjo mund të thuhet se kokrrat e polenit te kultivari Starking kanë qenë mjaft vitale dhe aktive në veçanti në fazat e lulëzimit të plotë dhe përfundimit të lulëzimit dhe përqendrimet e saharozës 15 % dhe 20 %. Kjo tregon se kultivari Starking paraqet një potencial të lartë polenizues për kultivarët tjerë të mollës.

Fjalët kyçe: Molla, Starking, poleni, mbirja, saharoza, lulëzimi.